



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi e gjuhë B (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri Viti II, Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të informojë studentin në lidhje me zhvillimet e letërsisë turke gjatë periudhës pas pranimit të fesë islame nga populli turk duke filluar nga shekujt XII-XIII deri në fillimet e shekullit XIX. Kjo periudhë karakterizohet nga zhvillimi i letërsisë turke në dy drejtime. Letërsia e Divanit (e thënë ndryshe letërisa e përzgjedhur) e cila do të zhvillohet nën ndikimin e kulturës së qytetërimit Islam dhe do të arrijë kulmin në shekujt XVI-XVIII gjatë shtetit Osman dhe letërsia e Ashikëve, letërsia popullore turke e cila do të fillojë të ndikohet nga kultura Islame por prap se prap do të mbesë më e afërt me popullin duke mos humbur karakterin e saj kombtarë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Njohuri mbi zhvillimin e letërsisë turke në shek. XII-XIII.
2. Njohuri mbi fillimet e letërsisë së divanit në shek. XIV-XV.
3. Njohuri mbi letërsinë e divanit në shek. XVI-XVII dhe autorët kryesorë.
4. Njohuri mbi letërsinë e divanit në shek. XVIII dhe autorët kryesorë.

Rezultatet e pritshme:

1. Përshkruajë zhvillimin historik të letërsisë turke pas pranimit të Islamit, duke dalluar periudhat kryesore nga shekulli XII deri në fillimet e shekullit XIX.
2. Dallojë karakteristikat themelore të letërsisë së Divanit dhe asaj të Ashikëve, duke identifikuar dallimet mes tyre në aspektin stilistik, tematik dhe kulturor.
3. Njohë dhe analizojë veprat dhe autorët kryesorë të të dy rrymave letrare, duke kuptuar ndikimet e kulturës islame në zhvillimin e tyre dhe rolin e tyre në historinë letrare turke.